



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 95, datë 16/02/2017

PËR

“KRYERJEN E INSPEKTIMEVE ON-LINE”

Në zbatim të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM Nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, Inspektorati Qendror ka trajnuar dhe ka pajisur me paketa portabël inspektorët, dhe me qëllim kryerjen e inspektimeve on-line nëpërmjet portalit unik “e-Inspektimi”,

URDHËROJ:

1. Për të rritur transparencën, efektivitetin, besueshmërinë e veprimtarisë inspektuese Inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese, të cilat janë pjesë e portalit unik “e-Inspektimi” duhet të kryejnë inspektime on-line, pranë subjekteve inspektuese.
2. Inspektoratet shtetërore/trupat e tjera inspektuese që duhet të fillojnë këtë proces për degën rajonale Tiranë janë:
 - ✓ Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
 - ✓ Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
 - ✓ Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve;
 - ✓ Inspektorati Shtetëror i Arsimit;
 - ✓ Inspektorati Shtetëror i Ujërave;
 - ✓ Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
 - ✓ Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
 - ✓ Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
 - ✓ Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.
3. Mos kryerja dhe dokumentimi i veprimtarisë inspektuese on-line do të konsiderohet si mospërbushje e detyrimeve ligjore dhe do t’ju ngarkojë me përgjegjësi administrative dhe ligjore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
SHKËLQIM HAJDARI